

Kërkesë për Propozime

Referenca: RFP/AQH/2026/001

24.02.2026

Projekti Accessible Quality Healthcare (AQH) financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Swiss TPH. Faza e tretë e projektit AQH filloi në janar 2024 dhe do të vazhdojë deri në dhjetor 2027. Projekti AQH është projektuar për të mbështetur zbatimin e agjendës kombëtare të reformave dhe për të plotësuar programet e tjera të mbështetura nga donatorët, me fokus në nivelin e Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) dhe sëmundjet jo-ngjitëse (SJN).

Projekti AQH fton organizatat e shoqërisë civile të kualifikuara, me përvojë të dëshmuar në mobilizimin e komunitetit dhe zbatimin e ndërhyrjeve pjesëmarrëse për promovimin e shëndetit, që synojnë parandalimin dhe menaxhimin e sëmundjeve jo-ngjitëse (SJN), në përputhje me objektivat e projektit, të paraqesin propozime për ofrimin e shërbimeve në vijim:

“Zbatimi i aktiviteteve të promovimit të shëndetit dhe edukimit shëndetësor në nivel komuniteti”

Lokacioni i ofrimit të shërbimeve përfshin rajonet dhe komunat përkatëse të Kosovës: Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.

Organizatat e interesuara që plotësojnë kriteret ftohen të marrin dokumentet e Kërkesës për Propozim (RFP) duke kontaktuar Zyrën e Projektit AQH në Prishtinë, Kosovë, përmes email-it: procurement@aqhproject.org.

Ju lutemi përfshini emrin ligjor të organizatës, numrin e regjistrimit dhe numrin fiskal gjatë paraqitjes së kërkesës. Dokumentet e RFP-së do të dërgohen në mënyrë elektronike organizatës kërkuese.

Afatet kohore të RFP-së

- **Publikimi i RFP-së:** 25.02.2026
- **Seancë e detyrueshme informative:** 05.03.2026, ora 10:00 AM [e kufizuar në një përfaqësues për OShC]
- **Afati i fundit për kërkimin e dokumenteve të RFP-së:** 11.03.2026, ora 12:00 AM
- **Afati i fundit për pyetje/sqarime:** 11.03.2026, ora 4:30 PM
- **Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve:** 18.03.2026, ora 11:00 AM
- **Hapja publike:** 18.03.2026, ora 11:05 AM [e kufizuar në një përfaqësues për OShC]

Kërkesat për dorëzim: Të gjitha propozimet duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur dhe t’i adresohen Projektit Accessible Quality Healthcare (AQH). Zarfi duhet të jetë i shënuar qartë me informacionin në vijim:

“Zbatimi i aktiviteteve të promovimit të shëndetit dhe edukimit shëndetësor në nivel komuniteti”
RFP/AQH/2026/001

Zarfi i mbyllur duhet të përmbajë:

- Një (1) kopje origjinale fizike të propozimit të plotë, përfshirë të gjithë dokumentacionin e kërkuar.
- Një (1) kopje shtesë fizike të propozimit të plotë.
- Një (1) kopje elektronike të propozimit të plotë, e ruajtur në USB ose CD.

Dorëzimet jo komplete ose propozimet që nuk përputhen me udhëzimet e mësipërme do të konsiderohen të papranueshme.

Për informata shtesë, ju lutemi kontaktoni Projektin AQH në adresën e email-it: procurement@aqhproject.org